



T1.1.1 Eco-museum cross-border model and network developed

Version Final

Guidelines in Albanian Language

2020

Lead Partner:



Project Partners:



Associated Partner:



Co.Co.Tour

Emri i Projektit ITALME-71

Mbrojtja, përmirësimi dhe promovimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të komuniteteve bregdetare duke fuqizuar modelin e ekomuzeut me qëllim menaxhimin e zgjuar e të qëndrueshëm të turizmit

DOKUMENT I PROJEKTIT

Partner i Projektit | PP3 | Shoqata MAGNA GRECIA MARE

Paketa e Punës | WPT1

Kodi i dokumentit | D.T1.1.3

Titulli i dokumentit | Udhëzime dhe standarde të përbashkëta për menaxhimin dhe promovimin e planit të ekomuzeut

Partners



Associated partner



Përmbajtja

1.	Përmbledhje e zgjeruar	3
2.	Përkufizim i përgjithshëm i ekomuzeut	3
3.	Ekomuzeu bregdetar dhe detar	4
4.	Prototipi i Portit-Muze të Tricases	5
5.	Udhëzime të përbashkëta	5
5.1	Udhëzime për përkufizimin dhe ngritjen e një ekomuzeu	6
5.2	Udhëzime për zhvillimin dhe menaxhimin e ekomuzeut	9
5.3	Udhëzime për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e komunitetit të ekomuzeut.....	14

Partners



Associated partner



1. Përmbledhje e zgjeruar

Ky dokument është përgatitur nga Shoqata PP3 Magna Grecia Mare me mbështetjen e ekspertizës së jashtme. Ai prezanton udhëzimet dhe standardet e përbashkëta për menaxhimin dhe promovimin e planit të ekomuzeut në kuadër të paketës së punës T1: Zhvillimi i një modeli ndërkufitar të ekomuzeut për rritjen e potencialit kulturor dhe turistik të komuniteteve bregdetare, aktiviteti A.T1.1 i projektit CO.CO.TOUR.

Udhëzimet e projektit CO.CO.TOUR kanë për qëllim të identifikojnë një model të përbashkët të ekomuzeut ndërkufitar dhe të fuqizojnë një rrjet ekomuzeu për t'ju dhënë më shumë vlerë pasurive të komuniteteve bregdetare.

Në veçanti, këto udhëzime janë hartuar mbi bazën e njohurive të mbledhura nga rezultatet dhe përvojat e partnerit italian të projektit (Porti-Muze i Tricases) dhe mbi mësimet e nxjerra përmes analizave territoriale të paraqitura gjatë një takimi pune ndërkufitar të posaçëm të mbajtur në Tricase.

Qëllimi përfundimtar i metodologjisë është të ofrojë një mjet që do të shërbejë për të mbështetur, nga ana teknike, nisjen dhe fuqizimin e projekteve të ekomuzeut “të orientuara nga mjedisi”.

Sipas përkufizimit të Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve (KNM), ekomuzeu duhet të klasifikohet më tepër si një proces se sa një produkt, dhe kjo është në varësi të komunitetit vendor. Ekomuzeu mbështetet në tre elemente kryesore:

1. **trashëgimia**, dhe jo koleksioni;
2. **territori**, dhe jo godina- mbajtëse;
3. **popullata**, dhe jo publiku

Mbi bazën e përkufizimit të ekomuzeut bregdetar, udhëzimet janë organizuar në tre grupe. Për secilin grup janë përcaktuar veprime dhe instrumente për arritjen e objektivave.

2. Përkufizim i përgjithshëm i ekomuzeut

Ekomuzeu është një muze i përhapur në komunitet që ofron një mekanizëm unik për angazhimin e komunitetit, ku pjesëtarët e komunitetit punojnë për të mirëmbajtur dhe mësuar nga trashëgimia e gjallë materiale dhe jo-materiale

Palët e interesit, përmes konsultimeve me komunitetin, bien dakord për pasuritë natyrore dhe kulturore që ato vlerësojnë dhe, më pas, hartojnë plane që këto pasuri të ruhen dhe përdoren për të nxitur kulturën e qëndrueshmërisë.

Partners



Associated partner



Ndryshe nga muzeu tradicional, ekomuzetë nuk grumbullojnë domosdoshmërisht objekte në një ambient muzeor. Përkundrazi, ato bëjnë të mundur që komunitetet të ruajnë objekte, vende dhe praktika kulturore me vlerë, aty ku ato ekzistojnë, duke rritur shikueshmërinë e tyre dhe kontributet që ato japin në aktivitetet e zhvillimit të komunitetit.

Ekomuzeu është një fenomen kulturor që buron nga marrëdhëniet mes një vendi specifik, ku përfshihen trashëgimia dhe objektet e artit, dhe njerëzve, të cilët formojnë një bashkësi dhe identitete që banojnë në atë vend. Ekomuzetë krijohen me pjesëmarrjen e tre grupeve kryesore, personelit, vizitorëve e banorëve vendas, si dhe me ndërveprimet dhe marrëdhëniet e tyre me objektet shoqëruese të artit dhe trashëgimisë së komunitetit dhe vendit në fjalë.

3. Ekomuzeu bregdetar dhe detar

Ekomuzeu bregdetar është një nga llojet e projekteve të ekomuzeut që mbështetet në rolin qendror që ka komuniteti vendas pritës bregdetar dhe detar që është edhe trashëgimia e tij “parësore dhe e ndjeshme”. Modeli i ekomuzeut bregdetar, i bazuar në një qasje të vërtetë nga poshtë-lart, zakonisht promovohet dhe mbështetet në mënyrë dinamike nga komunitetet mesdhetare bregdetare dhe të brigjeve lumore.

I gjithë cikli i projektit paraqitet si një proces pjesëmarrës i njohjes, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore vendore detare dhe bregdetare, duke bërë të mundur rritjen e qëndrueshme sociale, mjedisore dhe ekonomike.

Në këtë mënyrë, ekomuzeu kthehet në një institucion kulturor, të strukturuar në vende, itinerare dhe sisteme, duke siguruar, në një zonë të caktuar bregdetare dhe me përfshirjen e komunitetit vendas, kërkimin, ruajtjen dhe forcimin e pasurive mjedisore, historike dhe kulturore që përfaqësojnë mjedisin dhe stilet e jetesës që kanë ndjekur njëra-tjetrën, janë krijuar dhe kanë ndjekur zhvillimin e tij.

Është plotësisht e qartë se territori i ekomuzeut bregdetar duhet të përfshijë, në mënyrë ideale, një vend-port, si një vendndodhje simbolike e lidhjes së fortë të përbashkët mes komunitetit dhe kulturës së tij. Prania e portit, si një vend fizik dhe ideal, mbi të cilin dhe rreth të cilit zhvillohet projekti i ekomuzeut, përbën një kusht hapësinor me përparësi, ku do të nisë një projekt evolucionar i mbështetur në avantazhin që historikisht ofrohet nga portet, për sa i takon marrëdhëniet.

Partners



Associated partner



4. Prototipi i Portit-Muze të Tricases

Projekti CO.CO.TOUR njih modelin organizativ dhe administrativ të Portit-Muze të Tricases, si një prototip i marrë në referencë, i zhvilluar tashmë, dhe nga i cili do të merren përvoja dhe praktikat e mira.

Krijimi i Portit-Muze të Tricases u bë i mundur falë bashkimit të sinergjisë mes Bashkisë së Tricases, Shoqatës Magna Grecia Mare (subjekti menaxhues), Qendrës Ndërkombëtare për Studime Agronomike të Thelluara Mesdhetare të Barit (CIHEAM Bari), Parkut Rajonal “Bregu i Otrantos, Shën Maria e Leucas dhe Pylli i Tricases”, si dhe Universitetit të Salentos.

Ai u financua në kuadër të programit të bashkëpunimit territorial Itali-Greqi (INTERREG 2007 - 2013). I ndodhur në mes të zonës së mbrojtur të Parkut Rajonal Natyror të “Bregut të Otrantos, Shën Marisë së Leucas dhe Pyllit të Tricases”, Porti-Muze i Tricases është, ndoshta, shembulli unik konkret i muzealizimit “të përhapur” të një porti, detit të tij, territorit të tij bregdetar dhe bashkësisë së popujve që kanë jetuar aty qysh nga kohërat e lashta mes tokës dhe detit.

Ky është një nga modelet e pakta të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor, një shembull i përsosur dhe konkret i konceptit aktual të qëndrueshmërisë, i zbatuar në një komunitet mesdhetar bregdetar.

Porti-Muze i Tricases u njoh zyrtarisht si një “Ekomuze me interes rajonal” me vendimin Nr. 1182/2017 të Qeverisë Rajonale të Puglias, në përputhje me Ligjin Rajonal Nr. 15/2011, pas mendimit pro të Komitetit Konsultativ për Ekomuzetë, me nismën e Departamentit të Turizmit, Ekonomisë së Kulturës dhe Vlerësimit Territorial të Rajonit të Puglias.

5. Udhëzime të përbashkëta

Udhëzimet për planifikimin, fuqizimin dhe menaxhimin e ekomuzeut bregdetar janë konceptuar si një mjet i lehtë në përdorim që mbështet zgjedhjet e projektit në bazë të një ndërhyrje nga poshtë-lart.

Mbi këtë bazë, udhëzimet janë strukturuar në tre hapa të ndryshëm proceduralë që dallojnë për nga cikli i projektit të një ekomuzeu bregdetar. Këto tre hapa janë si më poshtë:

Hapi 1 - Përkufizimi dhe ngritja e një ekomuzeu

Hapi 2 - Zhvillimi dhe menaxhimi i ekomuzeut

Hapi 3 - Përfshirja dhe pjesëmarrja e aktorëve vendorë.

Për secilin hap, udhëzimet përcaktojnë veprimet e mundshme, rezultatet dhe mjetet operative që mund të aktivizohen, qoftë veçmas ose në mënyrë sinergjike, për të arritur objektivat e planifikuara.

Partners



Associated partner



Ndërsa dy hapat e parë mund të konsiderohen si hapa të njëpasnjëshëm dhe përgatitorë, hapi i tretë, i cili përfshin komunitetin vendor, mund të konsiderohet si horizontal për gjithë procesin e projektit të ekomuzeut, pasi zbatohet në çdo kohë.

5.1 Udhëzime për përkufizimin dhe ngritjen e një ekomuzeu

Ky hap mund të ndahet në katër veprime të ndryshme:

Përkufizimi dhe karakteristikat territoriale të ekomuzeut: këtu qëllimi është të dokumentohet që ekomuzeu i referohet një zone bregdetare dhe detare që karakterizohet nga një kulturë, pozicion gjeografik dhe peizazh homogjen. Kjo kërkon që të kontrollohet nëse komuniteti lokal i percepton pasuritë ekzistuese materiale dhe jo-materiale, të zonës në fjalë, si burime të krijimit të identitetit. Krijimi i hartës specifike synon të identifikojë çdo nismë tjetër kulturore në zonë me qëllim shmangim e dublikimeve dhe/ose promovimin e sinergjive.

Përcaktimi i objektivave dhe projektit kulturor: për sa i takon këtij veprimi, më poshtë do të gjeni, si shembull, objektivat e përfshira në statutin e Portit-Muze të Tricases, si qëllim i nismës së portit-muze.

Objektivat e portit-muze (siç përcaktohet në Statutin e Portit-Muze të Tricases)

- *Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit, institucioneve kulturore, shkencore dhe arsimore, aktiviteteve ekonomike, organeve dhe shoqatave vendase;*
- *Përmirësimi i burimeve ekzistuese njerëzore dhe mjedisore të zonës, dhe mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë historike, kulturore dhe artistike, natyrës dhe mjedisit, përmes trajnimit, menaxhimit dhe shpërndarjes së praktikave pjesëmarrëse në kontekstin e ekomuzeut;*
- *Mbështetja dhe zbatimi i projekteve arsimore, trajnuese, kërkimore dhe të bashkëpunimit, si dhe të seminareve edukative, me qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes aktive të popullatës lokale;*
- *Ruajtja dhe restaurimi i mjediseve tradicionale të jetesës, të cilat janë tipike për një zonë bregdetare dhe të një mjedisi/peizazhi detar, për të dëshmuar kulturën materiale dhe jo-materiale, zakonet e jetesës dhe të punës së popullsisë vendase, traditat fetare, kulturore dhe rekreacionale, përdorimin e burimeve natyrore, teknologjive, burimeve të energjisë dhe lëndëve të para të përdorura në veprimtaritë e prodhimit, duke i kushtuar rëndësi të veçantë peshkimit dhe punës në det dhe me detin, përfshirë marrëdhëniet e tyre të ngushta me prapatokën dhe popullsitë e tjera bregdetare, veçanërisht në Mesdhe;*
- *Dokumentimi, mbrojtja dhe rritja e vlerës së kujtesës historike të territorit, në shprehjet e tij materiale dhe jo-materiale, përmes zbatimit të një "menaxhimi" "aktiv" e të koordinuar të vendeve muzeore, qendrave të dokumentacionit dhe seminareve tematike edukuese, si dhe*

Partners



Associated partner



përfshirja dhe pjesëmarrja e popullsisë dhe institucioneve. Theksi është tek marrëdhënia me territorin për zhvillim të qëndrueshëm, në veçanti tek çështjet sociale, kulturore dhe ekonomike, me qëllim promovimin e njohjes më të gjerë të identiteteve dhe traditave lokale dhe mbrojtjen e mjedisit e peizazhit detar dhe bregdetar;

- Përbushja e misionit të ruajtjes, komunikimit dhe përhapjes së identitetit dhe vlerave të përbashkëta mes popullsisë dhe institucionet vendore arsimore, kulturore, shkencore, historike, natyrore, mjedisore dhe ekonomike;*
- Zbatimi i njohurive tradicionale përmes teknologjive moderne, duke synuar jo vetëm mbajtjen gjallë të traditave vendase, por edhe zhvillimin e potencialit të tyre, duke promovuar kështu një njohje më të gjerë dhe përhapje të tregtive dhe aftësive, edukimit mjedisor dhe respektimit të peizazhit, në veçanti të detit dhe bregdetit;*
- Organizimi i itinerareve turistike dhe kulturore që synojnë promovimin e njohjes së territorit dhe kulturës së tij, krijimin e mundësive për përdorimin e produkteve vendase, arsimit, sportit dhe aktiviteteve të kohës së lirë;*
- Nxitja e bashkëveprimit mes popullsisë dhe vizitorëve/turistëve me qëllim promovimin e jo vetëm formave të reja të turizmit të qëndrueshëm, por edhe të një kuptimi më të thellë të misionit të ekomuzeut;*
- Organizimi i nismave kulturore dhe edukative të projektuara për të rigjallëruar dhe promovuar trashëgiminë historike, kulturore dhe mjedisore të detit dhe bregdetit, në një kuptim më të gjerë, dhe të aktiviteteve të tyre dhe burimeve njerëzore;*
- Kryerja e shkëmbimeve sociale dhe ruajtja e dialogut mes brezave dhe popujve të vendeve fqinje të Mesdheut, me qëllim rigjallërimin e njohurive teknike dhe aftësive tradicionale manuale, si dhe ruajtja e marrëdhënieve korrekte mes konsumimit dhe përtëritjes së burimeve;*
- Mbështetja dhe promovimi i veprimtarive kërkimore-shkencore, edukative dhe të bashkëpunimit duke u përqendruar tek historia, kultura dhe artet tradicionale që lidhen, në veçanti, me peshkimin dhe detin, ndërveprimet e tyre me vendet e tokës në brendësi dhe vendet e tjera, jetesën dhe veprimtaritë tipike të territoreve bregdetare, si dhe mjedisin;*
- Koordinimi i veprimtarisë së tij me subjekte të ngjashme në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë vendet e Mesdheut, të cilat kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me popujt vendas;*
- Krijimi i një rrjeti marrëdhëniesh të dobishme kombëtare dhe ndërkombëtare për të realizuar qëllimet dhe përhapjen, pjesëmarrjen dhe shpërndarjen e rezultateve, duke nxitur kështu ndërmarrjen e nismave të ngjashme;*
- Pjesëmarrja në Rrjetin e Ekomuzeve dhe sistemet lokale dhe ndërkombëtare të ekomuzeve;*
- Ngritja e një sistemi pjesëmarrës të bazuar në komunitet, të karakterizuar nga aftësia organizative, përgjegjësia sipërmarrëse dhe bashkëpunimi institucional;*
- Nxitja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së popullsisë, pasi ekomuzeu përfaqëson shprehjen e kulturës së një territori dhe si pikën e tij kryesore të referencës ka komunitetin vendas.*

Në bazë të një Plani Zhvillimi specifik, të përcaktuar nga subjekti promovues i ekomuzeut bregdetar, qëndron përcaktimi i objektivave dhe misionit të ekomuzeut.

Ngritja e ekomuzeut: zakonisht promovimi i mbështetur nga krijuesi i nismës i paraprin këtij hapi të projektit të ekomuzeut. Prej natyrës së tij gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, projekti i ekomuzeut kërkon, qysh nga promovimi i tij, përfaqësimin kolektiv që duhet të nxisë procesin e njohjes dhe ndërgjegjësimit të komunitetit vendas. Në rajonet që kanë një kuadër rregullator specifik, ky parim mbështetet njëzëri nga rregulloret vendore që përcaktojnë rregullat për njohjen e statusit të “ekomuzeut me interes rajonal”.

Të dhënat kërkimore sugjerojnë se gjëja më e mirë është që promovimi i ekomuzeut t'i besohet një ose disa subjekteve, të tillë si:

- shoqatat dhe fondacionet kulturore dhe mjedisore jofitimprurëse me mision të posaçëm të përfshira në ruajtjen e trashëgimisë historike;
- autoritetet vendore individuale dhe bashkësitë e tyre;
- institucione kërkimore publike dhe private.

Sa i përket mënyrës së themelimit të një ekomuzeu, vlen të theksojmë se ka dy mënyra të ndryshme. Në rastin e parë, themelimi mbështetet në një rregullore të posaçme (si p.sh. shumica e rajoneve italiane kanë nga një ligj të posaçëm për ekomuzetë), ndërsa në rastin e dytë nuk mbështetet në asnjë kuadër rregullator (si Shqipëria dhe Mali i Zi). Në rastin e parë, rregullorja parashikon procedurën formale të themelimit, e cila rregullon gjithashtu edhe njohjen e tij juridike. Prandaj, është e nevojshme të identifikohet organi administruar, të caktohet emri, logo, si dhe të përcaktohet një rregullore e posaçme.

Miratimi i Statutit është një kusht thelbësor për themelimin e tij. Ai nuk është thjesht një veprim simbolik, por edhe një veprim thelbësor, përmes së cilit ekomuzeu përcakton vetveten dhe shpall qëllimet e tij dhe si synon t'i arrijë ato. Ai është element thelbësor i vetë identitetit të tij, përmes të cilit vërteton anëtarësimin e tij në botën e muzeve (Kodi i Praktikës së KNM-së kërkon ekzistencën e një Statuti për pranimin e një institucioni si muze) dhe të ekomuzeve (duke kontribuar kështu në një përkufizim të përbashkët të kërkesave minimale), duke theksuar gjithsesi specifikat e veta.

Secili ekomuze duhet të ketë një statut dhe/ose një rregullore të shkruar, e cila duhet të përcaktojë qartë:

- Natyrën e tij jofitimprurëse dhe të përhershme;
- Misionin dhe synimet e tij;
- Format e tij të qeverisjes dhe administrimit;
- Strukturën e tij financiare dhe të kontabilitetit;
- Rregullat dhe dispozitat e personelit;
- Pasuritë e tij;
- Parimet e përgjithshme të menaxhimit dhe trajtimit të koleksioneve;

Partners



Associated partner



- Parimet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve publike;
- Metodatat e mbledhjes së të dhënave gjatë veprimtarisë dhe menaxhimit, për qëllime statistikore dhe programimi;
- Funksionet dhe detyrat që ekomuzeu synon të kryejë në kontekst territorial, si dhe brenda kuadrit të një organizate të mundshme të përbashkët.

Akreditimi dhe njohja shkencore: në mënyrë të pavarur nga njohja juridike, ky veprim rezulton në krijimin e një rrjeti marrëdhëniesh dhe aktiviteteve të qëndrueshme bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe institucionet arsimore.

Ekomuzetë zakonisht krijojnë marrëdhënie bashkëpunimi duke u bashkuar në rrjete rajonale dhe/ose kombëtare dhe/ose ndërkombëtare. Një rast interesant, në këtë kontekst, është Porti-Muze i Tricases, i cili koordinon, përmes projektit WEBPORT, një rrjet me komunitete mesdhetare të peshkimit.

5.2 Udhëzime për zhvillimin dhe menaxhimin e ekomuzeut

Hapi që përfshin zhvillimin dhe menaxhimin e ekomuzeut mund të ndahet në këto veprime të mëposhtme:

Veprimi 1 - Përcaktimi i organizimit të brendshëm

Veprimi 2 - Identifikimi i burimeve organizative, njerëzore dhe financiare

Veprimi 3 - Kërkimi

Veprimi 4 - Ruajtja

Veprimi 5 - Përmirësimi

Veprimi 6 - Edukimi/trajnimi, informimi, komunikimi

Veprimi 7 - Monitorimi.

Kjo fazë përfshin, para së gjithash, përcaktimin e formave demokratike të menaxhimit dhe identifikimit të burimeve organizative, njerëzore dhe financiare për funksionimin e ekomuzeut.

Kërkimi: Pas përcaktimit të struktura organizative, së bashku me rolet e nevojshme profesionale për menaxhimin, nis veprimi i kërkimit për të identifikuar trashëgiminë e komunitetit përmes katalogimit, regjistrimit dhe njohjes. Këtu propozohen mjete inovative, siç është inventari pjesëmarrës.

Ky është një ushtrim kolektiv dhe bashkëpunues, i cili nënkupton identifikimin e të gjitha pasurive, qofshin ato materiale apo jo-materiale, natyrore apo kulturore, të cilat ndodhen në zonën e ekomuzeut dhe i përkasin komunitetit dhe anëtarëve të tij, dhe të cilat mund të ndahen dhe

Partners



Associated partner



përdoren nga të gjithë. Ky si proces përfshin ndërgjegjësimin e popullatës për vlerën e trashëgimisë dhe përgjegjësinë e tij për menaxhimin dhe fuqizimin e këtyre burimeve për zhvillim të qëndrueshëm. E gjithë kjo kërkon qasje të reja dhe origjinale, metoda ndërdisiplinore, praktika inovative dhe mund të kërkojë përfshirjen e profesionistëve (të tillë si antropologë, gjeografë, urbanistë, etj.). Mund të kërkojë gjithashtu mjete shtesë, siç janë inspektimet kolektive, ekspozitat gjithëpërfshirëse, etj.

Veprimi i kërkimit parashikon gjithashtu kryerjen e veprimtarive operative që synojnë rindërtimin historik të ndryshimeve sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore në zonën e ekomuzeut. Për këtë, mund të jenë të dobishme bashkëpunimet me universitete dhe/ose subjekte e qendra të tjera të përfshira në kërkime.

Në këtë drejtim, *Harta e Komunitetit ose e Famullisë* është një mjet veçanërisht efektiv falë dimensionit të saj gjithëpërfshirës.

Harta e famullisë është një mjet që mund të përdoret nga banorët e një vendi të caktuar për të përfaqësuar trashëgiminë, peizazhin, njohuritë që ata njohin si identitet të tyre dhe që dëshirojnë t'ia kalojnë brezave të ardhshëm. Ajo thekson mënyrën si komuniteti vendas sheh, percepton dhe i cakton vlera territorit të vet, kujtesës, transformimeve të tij, kushteve aktuale dhe pritjeve të tij për të ardhmen.

Ajo mund të përbëhet nga një hartë ose nga çfarëdolloj produkti tjetër ose pune që komuniteti e ndjen si të vetën.

Hartat e peizazhit përbëjnë një zhvillim të hartave të famullisë. Ky mjet buron nga koncepti se peizazhi është një shprehje e qytetërimit dhe kulturave multidisiplinare, dhe se është një pjesë e rëndësishme e cilësisë së jetës së njerëzve.

Ndryshe nga hartat e famullisë, “përmbajtja e organizuar” e hartave të ndryshme të peizazhit përbën drejtimin ose strategjinë e zbatuar në aktivitete, seminare dhe itinerare, përkatësisht në “faktet kulturore” të transpozuar në territor dhe të vëna në dispozicion për këdo në formën e aktiviteteve, tregimit, përvojave.

Zbatimi i hartave të peizazhit mund t'u besohet aktorëve që përfshihen në mënyrë aktive në komunitet.

Një tjetër mjet që forcon veprimin e kërkimit është “*Shëtitja nëpër Shtigjet e Trashëgimisë Kulturore*”. Shëtitja nëpër shtigjet e trashëgimisë kulturore projektohet dhe zbatohet nga njerëzit që jetojnë dhe punojnë në një zonë të caktuar të ekomuzeut, me të cilën ata ndajnë kujtime dhe përvoja historike, kulturore dhe/ose personale.

Qëllimi i saj kryesor është të rrisë ndërgjegjësimin e njerëzve, të cilësuar si subjekte, për bashkëveprimin e tyre me trashëgiminë kulturore me të cilën ata jetojnë dhe punojnë, në veçanti për përfitimet që rrjedhin nga të jetuarit të përfshirë në këtë “trashëgimi”, si për vlerat e saj historike ashtu edhe për aktivitetet e saj aktuale.

Partners



Associated partner



Shëtitja nëpër shtigjet e trashëgimisë kulturore mund të sjellë rezultate të ndryshme, në veçanti,:

- zbulimin ose rizbulimin e burimeve me vlerë që ofrohen nga vendi ku jetoni;
- sjelljen ndër mend të përvojave personale ose marrjen e përvojave të njerëzve/dëshmitarëve;
- zbulimin e aspekteve të reja të vendeve që konsideroheshin të njohura në tërësinë e tyre;
- rishfaqjen e kujtimeve të shuara;
- përvetësimin e njohurive;
- surpriza dhe argëtim
- emocione.

Shëtitja nëpër shtigjet e trashëgimisë kulturore dallon nga vizita me udhërrëfyes, që është më popullore, për këto arsye:

- është një format i hapur dhe fleksibël që mund dhe duhet të interpretohet nga ata që e projektojnë, dhe konceptohet dhe planifikohet nga vetë qytetarët, të cilët, pavarësisht nga profesionet që kanë, veprojnë si një komunitet i trashëgimisë kulturore;
- përqendrohet në një temë domethënëse, të marrë si faktori bashkues i njerëzve dhe vendeve të ekomuzeut;
- mbështetet në intervista me dëshmitarë, të cilët sjellin kujtime të së kaluarës për vendet e ekomuzeut, flasin për përvojën e tyre të drejtpërdrejtë, tregojnë për atë që i bën vendet të rëndësishme për ta dhe se cilat janë pritjet e tyre;
- tema është kulturore, në kuptimin e gjerë, dhe përfshin vendet e ekomuzeut që nuk preken nga fluksi i zakonshëm i vizitorëve dhe turistëve;
- I bën vendet private, të cilat janë zakonisht të mbyllura për publikun, të arritshme për vizitorët, në marrëveshje me pronarët që shpesh luajnë rolin e dëshmitarëve;
- shëtitjet zakonisht planifikohen dhe kryhen falas dhe mbi baza vullnetare. Sidoqoftë, ato mund të organizohen gjithashtu në emër të institucioneve, autoriteteve vendore ose organeve private, si një veprimtari kulturore me interes publik.

Ruajta: Ky veprim synon të rikuperojë hapësirat tradicionale që mund të ripërdoren për qëllime sociale, kulturore dhe turistike, duke rritur kështu ofertën e akomodimit përmes sipërmarrjes së nismave të “hoteleve të përhapura”.

Për më tepër, veprimi i ruajtjes që kryhet nga ekomuzeu synon të transmetojë dëshmitë dhe transformimet e kulturës materiale dhe jo-materiale. Një nga mënyrat për të arritur këtë rezultat është ndërmarrja e nismave për ringjalljen e njohurive antike, rizbulimin e traditave të trashëguara gojë më gojë dhe krijimin e një banke kujtese. Për shembull, Porti-Muze i Tricases ka prodhuar, ndër vite, një koleksion të madh të regjistrimeve audio dhe video me intervista të marinarëve, peshkatarëve, anijendërtuesve dhe dëshmitarëve të tjerë të jetës antike dhe të aktiviteteve që zhvilloheshin në port e që lidheshin drejtpërdrejt ose tërthorazi me peshkimin. Aktualisht, koleksioni

Partners



Associated partner



i dëshmime mund të shihet në arkivat e Qendrës së Përhershme Kulturore mbi traditat antike që lidhen me detin.

Përmirësimi: ka të bëjë me identifikimin dhe promovimin e mënyrave inovative të interpretimit të peizazhit dhe trashëgimisë kulturore. Interpretimi është thelbësor në veprimtarinë e ekomuzeut. Në kontekstin e sotëm, termi “interpretim” ka për qëllim të përshkruajë aktivitetet e komunikimit të përdorura për të promovuar kuptimin dhe përvojën brenda zonave natyrore, muzeve, vendeve historiko-arkologjike, etj.

“Interpretimi është një veprimtari edukative që synon të zbulojë kuptimet dhe lidhjet përmes objekteve origjinale, përvojave të drejtpërdrejta, materialit ilustrues dhe jo thjesht përmes komunikimit të një fakti.”

Në këtë fushë, aktivitetet e ekomuzeut mund të fillojnë nga krijimi i itinerareve e deri tek planifikimi i vizitave me udhërrëfyes të zbatuara me metoda tradicionale dhe/ose inovative.

Teknologjitë moderne mund të përdoren në mënyra të ndryshme për të lehtësuar dhe komunikuar interpretimin e një vendi, ku të gjitha synojnë lidhjen e veprimeve shqisore dhe konceptuale për të arritur në një ekuilibër mes pasurive materiale dhe jo-materiale. Për këtë qëllim, ekomuzeu duhet të ketë një Plan Interpretimi aktual ose një Strategji që ofron mjete të ndryshme për të siguruar një sistem komunikimi të integruar.

Plani i Interpretimit të ekomuzeut synon të arrijë objektiva afatshkurtra dhe afatgjata.

Qëllimet afatshkurtra:

- të pasurojë përvojën e vizitorëve të ekomuzeut;
- të njohë njerëzit me ekomuzeun ku ata ndodhen, në lidhje me territorin, duke u përqendruar në atë çfarë e bën të veçantë (duke prezantuar kuptimin e këtij vendi);
- të ofrojë një pikë qendrore për interpretimin e territorit në tërësi, si një njësi të vetme.
- të krijojë disa përvoja interpretuese kryesore dhe të motivojë vizitorët që të marrin pjesë në to (si për shembull, jeta e peshkatarëve, Tregtia brenda portit, etj.);
- të përcaktojë një program, një sistem edukativ që përfshin metodologji dhe standarde për operatorët e ekomuzeut, të cilët aplikojnë për t'u bërë “interpretues” përgjegjës;
- të shpjegojë integritet dhe marrëdhëniet mes bregdetit dhe tokës në brendësi duke u përqendruar në plotësimet me bujqësinë lokale, arkitekturën, mjedisin dhe stilin tradicional të jetës së vendit;
- të organizojë përvojat interpretuese të vizitorëve në mënyrë që t'ju kujtojë atyre konceptet thelbësore të të kuptuarit të territorit;
- të sigurojë një strukturë që lejon popullsitë vendase të ofrojnë përvoja interpretuese domethënëse dhe tërheqëse, për qëllime tregtare.

Qëllimet afatgjata:

Partners



Associated partner



- të zhvillojë një sistem që përfshin popullsinë lokale;
- të promovojë imazhin e zonës;
- të inkurajojë qëndrime dhe sjellje pozitive;
- të rrisë vlerësimin e vizitorëve për pasuritë natyrore dhe kulturore të vendit dhe të promovojë pjesëmarrjen e tyre në mbrojtjen e tij;
- të krijojë një “tërheqje” vjetore me përfshirjen e tërë popullsisë lokale.

Objektivi strategjik është që vizitorit t’i propozohet një udhëtim real dhe tërheqës nëpër ekomuze, përmes historisë së territorit dhe popujve që e gjallërojnë atë ose që e kanë përjetuar atë, përmes paneleve të ekspozitës, videove, rikonstruksioneve realiste, aktiviteteve interaktive, interpretimit të shëndoshë, miniaturave tredimensionale, kafshëve prej pelushi, librave dhe lojëra multimediale, etj.

Mënyra të tjera të mundshme të pasurimit të interpretimit të trashëgimisë ose peizazhit kulturor mund të përfshijnë:

- Vizitat me udhërrëfyes: mund të propozohen rrugë shëtitjeje që ndjekin topografinë antike të ekomuzeut, duke vendosur qendra të vogla vizitorësh me tema të veçanta pranë vendeve të rëndësishme të ekomuzeut;
- Koleksione objektesh: njohja e thellë e objekteve të së shkuarës, substancës së tyre, teknologjisë kryesore, përdorimit të tyre në zanatet e vjetra të kohëve antike (si peshkimi, detaria, ndërtimi i anijeve, përpunimi i gjësë së peshkuar), aura që i rrethon ato në histori dhe që i ka parë të luajnë një rol jetik, mund të jenë një mënyrë e shkëlqyer për të komunikuar identitetin e ekomuzeut;
- Shfaqjet teatrale për të rikonstruktuar ngjarjet përmes takimeve interpretuese të dramatizuara, (vënie në skenë të momenteve historike, tregimeve, personazheve, leximeve, etj.);
- Konkurse fotografish;
- Organizimi i ekspozitave të përkohshme;
- Krijimi i paketave edukative për shkollat;
- Hartimi i botimeve edukative dhe shkencore;
- Publikimi i novelave të shkurtra historike.

Rritja e vlerës së ekomuzeve bregdetar mund të realizohet përmes prodhimit të mallrave dhe shërbimeve. Në veçanti, ofrimi i shërbimeve është një nga mënyrat që siguron qëndrueshmërinë ekonomike të aktiviteteve të ekomuzeut. Shpesh, shërbimet ofrohen nga vullnetarë, por për disa lloj shërbimesh, duhet personel profesionit i kualifikuar.

Llojet e shërbimeve lidhen kryesisht me qasjen dhe përdorimin e vendeve dhe koleksioneve, si dhe me njohjen e veçorive kulturore lokale.

Partners



Associated partner



Shërbimet ofrohen shpesh në formën e seminareve eksperimentale, të cilët lejojnë vizitorët e ekomuzeut të bien në kontakt me vlerat tradicionale vendase, qofshin ato kulturore apo të lidhura me zejët, apo verën dhe ushqimin.

Edukimi, informimi dhe komunikimi: edukimi dhe informimi mund t'ju ofrohen si operatorëve të brendshëm të organizatës së ekomuzeut bregdetar, të cilët përfitojnë nga trajnimi i vazhdueshëm për rifreskimin e njohurive, ashtu edhe palëve të interesit, vizitorëve, dhe shkollave, përmes metodave të mësimdhënies.

Për shembull, Porti-Muze i Tricases jo vetëm që pret vizita shkollore, por kryen gjithashtu edhe aktivitete edukative me staf të kualifikuar në të gjitha institucionet arsimore të të gjitha llojeve dhe në të gjitha nivelet e vendosura në zonë, mbi bazë kërkesë. Në të dyja rastet, kjo gjë ofrohet në kuadrin e ditëve të hapura të rezervuara për shkollat, ku kryhen aktivitete praktike, si argëtimi (lidhja e nyjave të litarit, ndërtimi dhe vendosja në lundrim e barkave me vela të bëra me mbetjet e plazhit, riciklimi i tyre, kapja e erës, bërja e litarit, etj.).

Për grupet lokale të interesit, veprimet edukative përqendrohen në temat e biodiversitetit, mbrojtja e specieve të rrezikuara të peshqve, pritja e vizitorëve, menaxhimi i mbetjeve, mundësia e përdorimit të vendeve për vizitorë me nevoja të veçanta, sistemet e qëndrueshme të peshkimit, siguria në punë, protokollet e sigurisë ushqimore, etj.

Komunikimi i ekomuzeut është një çështje e madhe strategjike aq sa kërkon hartimin e një plani komunikimi.

Monitorimi: është një mjet strategjik që përbën bazën e vlerësimit të ekomuzeut dhe proceseve të vetëvlerësimit, të cilat ndihmojnë për ta bërë veprimin më efektiv përmes një ekzaminimi analitik të aspekteve individuale mbi bazën e treguesve dhe rezultateve.

Elementet që monitorohen më shpesh tek ekomuzetë përfshijnë, për shembull, pjesëmarrjen e të pranishmëve në nisma, megjithëse ky parametër është në thelb një numër që nuk pasqyron elemente që lidhen me cilësinë e nismave dhe, çështje më me rëndësi, me shkallën e përfshirjes së palëve të interesit ose vizitorëve. Në këtë drejtim, listat e kontrollit janë mjete operative shumë të efektshme për kryerjen e vetëvlerësimit.

Këtu mund të përfshihen gjithashtu pjesëmarrja në skemat vullnetare të certifikimit të cilësisë, të tilla si, për shembull, Herity International, organizata joqeveritare botërore për Certifikimin e Cilësisë së Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore.

5.3 Udhëzime për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e komunitetit të ekomuzeut

Ekomuzeu, si një shembull i ekomuzeut të përfshirë në mënyrë aktive në kërkimin dhe zbatimin e strategjive alternative për përmirësimin e trashëgimisë kulturore dhe mjedisore, mund të përfaqësojë, nëse merr forcë dhe mbështetet nga pjesëmarrja aktive e komuniteteve lokale, një

Partners



Associated partner



model efektiv të aftë të japë përgjigje praktike ndaj kërkesës në rritje për ndryshime të komuniteteve bregdetare lokale.

Që nga themelimi i tyre, ekomuzetë kanë propozuar një vizion të integruar dhe të qetë për marrëdhëniet mes njerëzve dhe ambientit të tyre rrethues, duke e mbështetur veprimin e tyre tek përfshirja aktive e komuniteteve lokale në menaxhimin dhe planifikimin me përgjegjësi të peizazhit. Në proceset e ekomuzeut, epërsia e komuniteteve është nxitësi kryesor i zgjedhjeve dhe strategjive. “Faza e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive realizohet përmes veprimeve të mëposhtme:

Veprimi 1 - Përkufizimi i komunitetit të ekomuzeut

Veprimi 2 - Ndërgjegjësimi dhe trajnimi

Veprimi 3 - Përfshirja dhe promovimi i formave të qëndrueshme të pjesëmarrjes.

Përkufizimi i bashkësisë së ekomuzeut: ky veprim mund të zbatohet në mënyrë efektive përmes një analize të grupeve të interesit. Për sa i përket rezultatit, ky mjet rezulton në Hartën e Grupeve të Interesit, dhe ka për qëllim të identifikojë në një mënyrë të strukturuar dhe efektive grupet kryesore të interesit që organizata e ekomuzeut duhet të marrë parasysh në aktivitetet e saj. Sidoqoftë, është e qartë që identifikimi i aktorëve vendas nuk duhet të përjashtojë përfshirjen e aktorëve institucionalë, siç janë autoritetet dhe institucionet vendore drejtpërdrejt të lidhura me qeverinë vendore. Aktorët jo-institucionalë kryesisht janë grupi promovues i ekomuzeut, shoqatat lokale dhe të gjitha kategoritë e veprimtarive tipike ekonomike që zhvillohen në territor (peshkatarët, fermerët, zejtarët, përpunuesit e produkteve vendore, etj.), përveç kategorive të ndryshme të akomodimit të turistëve (si hotele, ferma turistike, kamping, shtëpitë që ofrojnë shtratin dhe mëngjesin, etj.), bizneset restorante, vullnetarë dhe shërbime (si zhytja, udhërrëfyesit mjedisorë, dhënia me qira, etj.). Banorët, vizitorët, operatorët kulturorë, sportivë e të artit, si dhe aktorë të tjerë vendas që së bashku përbëjnë komunitetin lokal, janë pjesë integrale e analizës së grupeve të interesit. Nxitja e bashkëveprimit mes numrit më të madh të grupeve sociale në zonë është një garanci për projektin e ekomuzeut. Kjo pasi larmia e madhe e aktorëve të përfshirë reflekton nocionin e “shpërndarjes së trashëgimisë lokale”, e cila është një pronë kulturore kolektive që kërkon një përgjegjësi dhe mbikëqyrje të ndarë në mënyrë të barabartë mes aktorëve.

Ndërgjegjësimi dhe trajnimi: ky veprim synon krijimin e konsensusit dhe përfshirjen e komunitetit lokal në aktivitetet e ekomuzeut. Kjo do të sjellë nxitjen e pjesëmarrjes së komunitetit në programe dhe projekte, ndërkohë komuniteti do të përfshihet në identifikimin dhe menaxhimin e projekteve, nismave, propozimeve dhe strategjive. Për këtë qëllim, në këtë fazë, promovimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit do të ishte i dobishëm për projektin e përgjithshëm të ekomuzeut, duke theksuar përfitimet për mbarë komunitetin bregdetar dhe detar, duke vendosur theksin, në veçanti, tek temat që lidhen me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë lokale materiale dhe jo-materiale. Në këtë fazë, promovimi i debateve publike dhe seminareve kanë rol kyç. Komuniteti vendas ftohet të marrë pjesë dhe të trajtojë kompleksitetin e çështjeve dhe marrëdhënieve territoriale.

Përfshirja dhe promovimi i formave të qëndrueshme të pjesëmarrjes: siç është përmendur tashmë, përfshirja e komunitetit lokal është një proces pjesëmarrës që prek horizontalisht të gjitha fazat e

Partners



Associated partner



projektit të ekomuzeut. Shkalla e përfshirjes së komunitetit lokal zakonisht zvogëlohet në fazën e promovimit dhe nisjes së iniciativës, dhe më pas rritet pasi ekomuzeu krijon reputacionin e tij dhe organizata rritet.

Për përfshirjen e qytetarëve përdoren instrumente të ndryshme (si forume, seminare, etj.). Ato mund të përdoren në mënyrë jo-ekskluzive dhe madje plotësuese, brenda disa proceseve të mirë-vendosura që përdoren për konsultimet mes aktorëve vendas (metoda e planifikimit të projektit e orientuar drejt qëllimit, Metaplan, teknika e teknologjisë së hapësirës së hapur (Open Space Technology), Seminari Ndërgjegjes Evropiane (metoda EASW) etj.).

Partners



Associated partner



DISCLAIMER

Ky projekt është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit për Ndhmën e Para-Anëtarësimit (IPA II)

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e shoqatës Magnia Grecia Mare dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian dhe të Autoriteteve të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi.